



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 07**

Datë: **06. 02. 2024.**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**2. Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

**2.2.Këshilli për Çështje Ligjore**

**Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Glllogvc**

**3. Të ndryshme**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Në këtë takim “on line”, është shqyrtuar një pikë e rendit të ditës. Të ndryshme, nuk ka pasur. Pikë e shqyrtimit, ka qenë zëvendësimi i anëtarit të kuvendit komunal.

## **2.Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

### **2.2.Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në

Gllgovc:

Këshilli për Çështje Ligjore, paraprakisht e ka shqyrtuar kërkesën e Kuvendit Komunal të Gllgocit për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit. Këshilli, pasi ka ndjekur procedurat ligjore, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e duhura për t'i bërë ky zëvendësim. Në mbështetjeje me procedurat, i ka rekomanduar KQZ-së që, ta zbatoj rekomandimin e këshillit.

Në takimin e sotëm, anëtarët e KQZ-së e kanë miratuar rekomandimin e KCL, dhe kanë vendosur, që: zonja Kosovare Halili – Karaxha, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal të Gllgocit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, duke e zëvendësuar anëtares e deritashme të kuvendit, znj. Albulena Sadiku.

Për kanë votuar: Kreshnik Radoniqi, Sami Hamiti, Fazli Stollaj, Sami Kurteshi, Myfera Shinik, Ibrahim Selmanaj dhe Gordana Llaban.

### **3.Të ndryshme !**

---

***P.s***

***Kjo mbledhje është mbajtur "On – line".***